



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 7 të Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen urgjente, të mbajtur më 15.01.2016, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E MEMORIALIT
PËRKUJTMOR KUSHTUAR USHTARËVE SLOVAKË TË KFOR-IT

Neni 1

Miratohet Vendimi për vendosjen e memorialit përkujtimor kushtuar ushtarëve sllovakë të KFOR-it, në Parkun e qytetit të Prishtinës.

Neni 2

Lokacioni për vendosjen e memorialit përkujtimor kushtuar ushtarëve sllovakë të KFOR-it, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 6559-0, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi P.SH., Kuvendi Komunal Prishtinë.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së memorialit përkujtimor kushtuar ushtarëve sllovakë të KFOR-it, në lokacionin e përshkruar në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa grafike - skica e lokacionit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Financave dhe e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb- faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

ARSYETIM

I Vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e memorialit përkujtimor kushtuar ushtarëve sllovakë të KFOR-it

Përmes shkresës nr. 05-353-263312, të dt. 19.11.2015, kabineti i Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës i është drejtuar kësaj drejtorie me kërkesë për caktimin e lokacionit për ngritjen e memorialit përkujtimor kushtuar ushtarëve sllovakë të KFOR-it.

Në bashkëpunim me kabinetin e Kryetarit dhe shefin e Zyrës sllovaqe, është vizituar lokacioni i propozuar në Parkun e qytetit të Prishtinës, ku janë analizuar disa pozicione për vendosjen e pllakës përkujtimore dhe është propozuar lokacioni në pjesën e parcelës kadastrale 6559-0 ZK Prishtinë (P.SH., Kuvendi Komunal Prishtinës), të paraqitur në pjesën grafike të këtij arsytimi.

Ky memorial do të jetë një pllakë graniti me dimensione të përafërta (1.0 x 2.0) m, me mbishkrimin përkatës për ushtarët sllovakë të KFOR-it.

